



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.5868/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Hysni Ismaili, në çështjen juridike kontestimore të paditësit D.M., nga P., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve Studio Ligjore & Financiare “K. & A.”, me seli në P., kundër të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në P., me objekt kontesti kompensim i pagës mbi bazën e inflacionit, jashtë seancës, me datë 13.02.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHT MIRATOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit D.M., ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në P., që paditësit në emër të kompensimit për inflacion për periudhën kohore nga data 01.01.2019 e deri më datë 21.11.2022, për 46 muaj e 21 ditë, t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 915.51€.

II. DETYROHET e paditura që paditësit, shumën e gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t’ia paguaj me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data 16.11.2022, (data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 124€, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit mbi shumën e gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi për pagesën shtesë për inflacion, nga data 22.11.2022, e deri me datë 31.12.2022, në shumë prej 88.87€, **SI E PABAZUAR.**

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, pranë kësaj gjykate, me datë 16.11.2022, ka parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensim e pagave mbi bazën e inflacionit. Në padi si dhe në parashtrësën e datës 11.01.2024, i autorizuari i paditësit ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënëse, me tej ka theksuar se bazuar në nenin 35 para 10, i Kontratës Kolektive të Arsimit, të datës 18.04.2017 dhe datës 21.01.2021, shkalla e

Inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e Inflacionit futet në pagë, për vitin 2019 me shkallë të inflacioni 2.7% dhe paga e pranuar ka qenë 459€ dhe i takon shuma 148.71€, për vitin 2020 me shkallë të inflacionit 0.2% dhe paga e pranuar ka qenë 459€ dhe i takon shuma 11.04€, për vitin 2021, shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, paga e pranuar ka qenë 459€ dhe i takon shuma 187.2€, për vitin 2022, shkalla e inflacionit ka qenë 11.6% dhe paga e pranuar ka qenë 459€ dhe i takon shuma 572.83€, e në total për periudhën 01.01.2019 deri me datë 31.12.2022, shumën prej 1,004.38€ dhe kamatën e përlllogaritur për vonesë 83.39€. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë 104€ për përpilim të padisë, për taksë gjyqësore shumën prej 21€ dhe për precizim të padisë shumën prej 104€.

E paditura me përgjigjen në padi ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, për arsye se një kompensim i tillë nuk është paraparë as me Ligjin e Punës nr.03/L-212. Tutje ka theksuar se e paditura gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka paraparë në skemën e saj buxhetore, linjë të veçantë buxhetore për këto lloje të kompensimeve. Prandaj, ka kërkuar nga gjykata pas administrimit të provave kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e provave të bashkangjitura padisë, si dhe pas pranimit të përgjigjes në padi, mbështetur në nenin 8, 398 dhe 399 të LPK-së, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, por se e paditura ka ngritur çështje që kanë të bëjnë me pamundësinë e përmbushjes së detyrimit. Në këtë rast kontestues është vlerësuar se nuk ka pengesa në kuptim të dhënies së vendimit meritor jashtë seance.

Nga provat e bashkangjitura padisë, gjykata gjeti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura sipas kontratës me numër të protokollit 35, të datës 01.09.2014 dhe nga lista e pagës, vërtetohet se paga bazë e paditësit është 459€.

Në nenin 35 paragrafi 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi nga data 18.04.2017 dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi nga data 21.01.2021, parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”.

Nga vërtetimi i gjendjes faktike, vërtetohet se paditësit D.M., në emër të kompensimit për inflacion i takon shuma e përgjithshme prej 915.51€, pasi që shkalla e inflacionit për periudhën kohore prej datës 01.01.2019 deri 31.12.2019 ka qenë 2.7% andaj ka llogaritur pagën bazë të paditësit (paga 459€ x 2.7%=12.39€) shumëzuar për 12 muaj përfitohet shuma 148.71€, prej datës 01.01.2020 deri 31.12.2020 ka qenë 0.2% andaj ka llogaritur pagën bazë të paditëses (paga 459€ x 0.2%=0.91€) shumëzuar për 12 muaj përfitohet shuma 11.01€; për periudhën kohore prej datës 01.01.2021 deri 31.12.2021 ka qenë 3.4% andaj ka llogaritur pagën bazë të paditëses (paga 459€ x 3.4%=15.6€) shumëzuar për 12 muaj përfitohet shuma 187.2€ si dhe për periudhën kohore prej datës 01.01.2022 deri 21.11.2022 ka qenë 11.6% andaj për 10 muaj e 21 ditë, gjykata ka llogaritur pagën bazë të paditëses (paga 459€ x 11.6%=53.24€) shumëzuar për 10 muaj përfitohet shuma 532.44€ si dhe për 21 ditë, gjykata ka llogaritur shumën e rezultuar prej 53.24€

duke e pjesëtuar me 30 ditë, përfitohet shuma prej 1.71 e cila kur shumëzohet për 21 ditë na jep shumën prej 35.91€, e në shumë të përgjithshme për 10 muaj e 21 ditë, shumën prej 568.5€. Andaj paditësi e ka cilësinë e kreditorit, ndërsa e paditura cilësinë e debitorit, bazuar në nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), në të cilin përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë së paditësit gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, lidhur me pagesën shtesë për inflacion, 21.11.2022, e deri me datë 31.12.2022, në shumë prej 88.87€, gjykata gjeti se për këtë periudhë kohore paditësit nuk i takon një kompensim i tillë duke pas parasysh faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi me datë 21.01.2021, më nuk ka efekt dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime për asnjë kërkesë e cila ka lindur pas shkëputjes së kësaj Kontratë, me datë 22.11.2022, ngase ky fakt i konstatuar nga gjykata vërtetohet në Mendimin Juridik nga Gjykata Supreme e Kosovës, të datës 05.10.2023, ku është theksuar se Kontrata Kolektive e Arsimit është shkëput me datë 22.11.2022.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës Gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 449 dhe 452 e lidhur me nenin 463 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara i referohen shpenzimeve të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit për padi shumën 104 € dhe për taksë gjyqësore shumën 20€, (sipas nr. tarifor 6 dhe 7, të tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës). Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me shpenzimet e procedurës, i mori parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme dhe që janë krijuar për këtë procedurë.

Andaj duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.5868/2022 datë 13.02.2025

Gjyqtari
Hysni Ismaili

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.